

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7045
E hënë, 13 nëntor 2023
Çmimi 0.50

Familjet e prekura nga vërshimet ankohen për vonesë të dëmshpërblimeve | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI) KA SHPALOSUR VLERËSIME SE KAH PO SHKON KOSOVA SA I PËRKET LUFTIMIT TË KORRUPSIONIT DHE QEVERISJES DEMOKRATIKE

KDI-ja: KY VIT U PËRCOLL ME SËLME TË VAZHDUESHME TË EKZEKUTIVIT NDAJ INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË



Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur konferencë për medie në të cilën ka shpalosur vlerësimet lidhur me luftimin e korrupsionit dhe qeverisjen demokratike në Kosovë, bazuar në vërejtjet e Raportit të BE-së për Kosovën për vitin 2023. KDI-ja ka

ofruar rekomandime që do të mund ta përmirësonin gjendjen sa i përket luftës kundër korrupsionit, reformës në drejtësi, prokurimit publik, sinjalizimit, punës së Kuvendit të Kosovës dhe dialogut me Serbinë. Për këtë të fundit, KDI-ja ka kërkuar më shumë

transparencë nga qeveria. Sa i përket luftës kundër korrupsionit, KDI-ja ka theksuar se qeveria ende nuk ka një vizion të qartë për luftimin e korrupsionit, për faktin që edhe pse kanë kaluar dy vjet qeverisje, ende nuk ka një Strategji Kombëtare Kundër Korrupsionit

AKTUALE



VDES ISH-DIPLOMATI I LARTË ÇEK KAREL SCHWARZENBERG | F. 2

RRUGA TE RRETHI NË LAKRISHTË, SË SHPEJTI LËSHOHET PËR QARKULLIM | F. 6

DAKA: GJATË KËTIJ VITI KEMI PRANUAR RRETH 581 KËRKESA PËR LIRIM ME KUSHT | F. 6

EKONOMI



SHTOHEM PARATË FALSE NË TREGUN E KOSOVËS | F. 7


KURTI GJATË TAKIMEVE NË PARIS FLET PËR MUNDËSITË E BASHKËPUNIMIT NË FUSHËN E ENERGJISË | F. 7

SPORT



KOSOVA TRIUMFON KUNDËR IZRAELIT | F. 10

ASOCIACIONI I JEP MUNDËSI SERBISË TË FUNKSIONOJË BREND KOSOVËS | FAQE 3



LUFTIME TË ASHPRA AFËR SPITALIT KRYESOR TË GAZËS, NETANYAHU INJORON THIRRJET PËR ARMËPUSHIM | FAQE 2



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mbx: +377 44 501 289
E-mail: renova@t.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Luftime të ashpra afër spitalit kryesor të Gazës, Netanyahu injoron thirrjet për armëpushim

GAZA, 12 NËNTOR - Izraeli e bombardoi me breshëri raketash qytetin e Gazës gjatë natës së shtunë dhe mëngjesit të së dielës derisa forcat tokësore luftuan me militantët e Hamasit pranë spitalit më të madh të këtij vendi, ku zyrtarët shëndetësorë thanë se mijëra mjekë, pacientë dhe të zhvendosur kanë ngecur brenda tij pa rrymë dhe pa furnizime.

Në një fjalim televiziv të shtunën mbrëma, kryeministri i Izraelit, Benjamin Netanyahu, i hodhi poshtë thirrjet e vazhdueshme ndërkombëtare për një armëpushim, duke thënë se nuk do të ndodhë nëse nuk lirohen të gjitha 240 pengjet që grupi radikal Hamas, i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja, i rrëmbeu më 7 tetor gjatë sulmeve që e nxitën këtë luftë.

Ai tha se Izraeli do ta përdorë "tërë fuqinë" në këtë luftë.

Izraeli është zotuar për t'i dhënë fund sundimit 16-vjeçar të Hamasit në Gazë dhe për t'ia shkatërruar të gjitha kapacitetet ushtarake, duke i fajësuar militantët për dëmet ndaj 2.3 milionë palestinezëve të ngecur në territorin e rrethuar.

Por, Izraeli është përballur me trysni të madhe ndërkombëtare për shkak të numrit të madh të civilëve të vrarë në Gazë.

Në Qytetin e Gazës banorët raportuan për sulme të mëdha ajrore dhe granatime gjatë natës, përfshirë në zonën përreth spitalit Shifa.

Izraeli, pa dhënë prova, e ka akuzuar Hamasin se po e përdor spitalin Shifa si qendër të komandës dhe se nën të ka ndërtuar bunkerë. Këto akuza janë



mohuar nga Hamasi dhe stafi i spitalit. "Ne e kaluam natën në panik duke pritur ardhjen e tyre", tha Ahme dal-Boursh, një banor që po strehohet në Shifa. "Ata janë jashtë, jo larg nga portat e spitalit", theksoi ai, raporton "Associated Press".

Spitali nuk punon më

Gjeneratori i fundit i spitalit mbeti pa karburant të shtunën, duke shkaktuar vdekjen e një foshnje të lindur para kohe dhe të një fëmije në inkubator, si dhe të katër pacientëve të tjerë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë së Gazës, e cila udhëhiqet nga Hamasi.

Ajo thotë se 37 foshnja të tjera janë në rrezik për shkak të mungesës së rrymës.

Nënkryetari i Ministrisë së Shëndetësisë, Muniral-Boursh, tha se snajperët e Izraelit janë vendosur përreth spitalit Shifa, dhe

se po shtien ndaj kujtdo që lëviz në oborrin e tij. "Kemi të plagosur në shtëpi dhe nuk po mund të arrijmë te ta", tha ai për televizionin "Al Jazeera" në një intervistë nga spitali. "Ne nuk guxojmë ta nxjerrim kokën në dritare."

Ushtria e Izraelit tha se është e gatshme për t'i evakuuar foshnjat dhe civilët nga spitali Shifa drejt jugut të Gazës, por njerëzit që po strehohen në spital thonë se ndihet të frikësuar të dalin jashtë. Zëdhënësi i Forcave të Mbrojtjes të Izraelit (IDF), Daniel Hagari, tha të shtunën vonë se ekziston një korridor i sigurt përmes të cilit mund të evakohen civilët nga spitali Shifa për në jug të Gazës.

Gjendja në dhe përreth spitalit Shifa nuk mund të verifikohet në mënyrë të pavarur.

Ministria e Shëndetësisë e Gazës tha se në Shifa janë ende 1 500 pacientë, bashkë me një staf mjekësor prej 1 500 vetash, si dhe

me rreth 15 000 deri në 20 000 njerëz të strehuar.

Meqë Shifa dhe spitalet e tjera nuk punojnë më, njerëzit e strehuar në Qytetin e Gazës thanë se nuk kanë më qasje në kujdes intensiv.

Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara tha se një nga komplekset e saj u godit. Agjencitë e OKB-së nuk kanë qenë në gjendje të ofrojnë shërbime në veri të Gazës tash e disa javë.

Perioda të shkurtra evakuimi, por jo pauza

Shtetet e Bashkuara kanë bërë trysni për pauza të përkohshme në luftime të cilat do të mundësonin shpërndarje më të madhe të ndihmave tejet të nevojshme humanitare për civilët në territorin e rrethuar, ku kushtet janë shumë të rënda. Por, Izraeli është pajtuar vetëm për periudha të shkurtra

ditore gjatë të cilave civilët mund të ikin nga zonat e luftimeve në veri të Gazës dhe të shkojnë drejt jugut në këmbë, megjithëse Ushtria izraelite po i bombardon, siç i quan ajo, caqet militante nëpër jug të Gazës, po ashtu, shpesh duke vrarë gra dhe fëmijë.

Dhjetëra të plagosur, përfshirë fëmijë, u sollën në një spital në Jonis Kan, pasi sulmet ajrore izraelite e rrënuan një ndërtesë në jug të qytetit. Zyrtarët e spitalit thanë se së paku 13 njerëz u vranë. Si pasojë e luftës, rreth dy e treta e popullsisë së Gazës është zhvendosur brenda vendit, shumica kanë ikur në jug. Egjipti i ka lejuar qindra njerëz me pasaportë të huaja dhe të lënduar rëndë të largohen nga Gaza përmes pikëkalimit Rafah, si dhe futjen e disa ndihmave humanitare.

Më shumë se 11 000 palestinezë, dy e treta gra dhe fëmijë, janë vrarë prej se nisi lufta, sipas Ministrisë së Shëndetësisë së Gazës, e cila nuk e bën dallimin mes civilëve dhe militantëve të vdekur në përlllogaritje. Rreth 2 700 janë raportuar të zhdukur dhe besohet se kanë ngecur apo vdekur nën rrënoja.

Së paku 1 200 njerëz u vranë në Izrael, shumica e tyre civilë, në sulmin fillestar të Hamasit, i cili e nxitë luftën.

Ndërsa 46 ushtarë izraelitë janë vrarë në Gazë prej fillimit të ofensivës tokësore.

Rreth 250 000 izraelitë janë detyruar të evakohen nga komunitetet pranë Gazës, ku militantët palestinezë po gjuajnë ende me raketa, si dhe përgjatë kufirit verior me Libanin.

Vdes ish-diplomati i lartë çek Karel Schwarzenberg

PRAGË, 12 NËNTOR - Ish-ministri i Jashtëm i Republikës së Çekisë, Karel Schwarzenberg, një prej figurave kryesore të vendit në kohën pas komunizmit, ka vdekur të dielën në moshën 85-vjeçare, njoftuan zyrtarët çekë. Schwarzenberg e kishte mbështetur pavarësinë e Kosovës edhe para se ajo të shpallej nga Prishtina zyrtare në shkurt 2008, ndërsa ishte ministër i Jashtëm kur Çekia e njohu atë në maj 2008.

Schwarzenbergu kishte shërbyer dy herë si ministër i Jashtëm i Çekisë mes viteve 2007 dhe 2013 dhe në Kosovë shihej si një mik i vendit.

Në janar të vitit 2008, një muaj para se Kosova të shpallej e pavarur, Schwarzenbergu kishte thënë se "në një kohë të duhur Çekia do ta përkrahë Deklaratën e Pavarësisë së

Kosovës".

Më vonë, vetëm dy ditë pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ai kishte treguar vullnetin për ta njohur pavarësinë e saj.

"Ne do të shohim se sa vende evropiane do ta njohin Kosovën, dhe se si do të sillt Qeveria e Kosovës. Ne do ta marrim vendimin bazuar në këto fakte. Për këtë arsye nuk do të përmend ndonjë datë në veçanti. Ne do të punojmë me fakte, dhe jo data", kishte thënë ai më 19 shkurt të vitit 2008.

Vendimi i tij ishte kundërshtuar nga disa parti politike, përfshirë edhe ish-presidentin Vaclav Klaus. Në fakt, edhe presidenti i atëhershëm i Çekisë, Millosh Zeman, që konsiderohej më i afërt me Rusinë, nuk njihje si mbështetës i Pavarësisë së Kosovës.



Asociacioni i jep mundësi Serbisë të funksionojë brenda Kosovës

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Burim Ramadani, analist i sigurisë, ka publikuar draft-statutin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe që është propozuar nga pesë emisarë të BE-së dhe të ShBA-së. Ai ka thënë se nuk e di a është në mënyrë përfundimtare i pranuar nga Kosova ky version. "Sidoqoftë, nëse ky dokument do të mund të ndryshohet - vështirë të thuhet, por ajo që besoj unë është që Kosova duhet të fitojë diçka seriozisht të madhe si parakusht për zbatim të këtij dokumenti. Sepse ky draft-statut është shumë i gjerë dhe i thellë. Serioz në kompetencat që ia atribuon Asociacionit, mbi të gjitha shumë serioz në mundësinë që ia jep Serbisë që të funksionojë brenda Kosovës. Dhe kjo sidomos në arsim dhe shëndetësi, kujdes social, në financim dhe donacione e të ngjashme", ka thënë Ramadani. Ai ka thënë se, sipas dokumentit që ka siguruar, draft-statuti ka gjithsej 45 nene dhe ndahet në 7 kapituj. "Është saktësisht draft-statuti që i është dhënë kryeministrit Kurti. Është më ndryshe nga ai i Edi Ramës, edhe më ndryshe nga ai i FES-it, dhe shumë më ndryshe nga ai i Serbisë. Po tentoj që të mos komentoj draft-statutin, sepse kam bindjen se ky draft-statut do të jetë një prej debateve të pashtershme në Kosovë për një kohë më të gjatë", ka thënë Ramadani, duke shtuar se, tekefundit, ka ekspertë të fushës juridike dhe të qeverisjes lokale që mund të komentojnë me më shumë kompetencë. "Por, mbi të gjitha, është Gjykata Kushtetuese ajo që do ta jep verdiktin nëse ky draft-statut është në përputhje me Kushtetutën, në gërmë dhe frymë, apo nuk është i tillë", ka thënë Ramadani me rastin e publikimit të këtij dokumenti. Sipas këtij dokumenti, Asociacioni quhet "Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë". Selia e Asociacionit do të jetë në Mitrovicën e Veriut, përpos nëse komunat anëtare vendosin ndryshe pastaj. Asociacioni, i themeluar me këtë statut, ofron një kornizë vetëmenaxhuese për komunitetin serb të Kosovës brenda nivelit ekzistues komunal të vetëqeverisjes lokale dhe nuk do të fitojë kompetenca ekzekutive shtesë në krahasim me komunat anëtare të saj. Korniza përfshin mbështetjen e ofrimit të shërbimeve të koordinuara në fusha specifike, me mundësinë për mbështetje financiare nga Serbia dhe një



kanal efektiv komunikimi i drejtpërdrejtë për komunitetin serb të Kosovës në Qeverinë e Kosovës përmes Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal. Asociacioni ka personalitet juridik, në përputhje me ligjin në fuqi, dhe kapacitetin juridik të nevojshëm sipas ligjit të Kosovës për t'i përmbushur objektivat e saj, duke përfshirë të drejtën për të pasur pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, për të pasur kompani në bashkëpronësi që ofrojnë shërbime lokale brenda fushëveprimit të Asociacionit dhe të lidhë kontrata, përfshirë kontratat e punës, si dhe të padisë dhe të paditet. Anëtarët e Asociacionit nuk mund ta transferojnë pronësinë e pronës së tyre të paluajtshme tek Asociacioni. Komunitetet e tjera (joserbe) duhet të përfaqësohen në të gjitha organet e Asociacionit duke reflektuar diversitetin etnik të komunave anëtare. Asociacioni do t'i krijojë simbolet e veta zyrtare, të cilat mund të përbëhen nga një flamur dhe një stemë. Në përputhje me ligjin në fuqi, Asociacioni do të ketë të drejtë të bashkëpunojë, brenda fushave të kompetencave të anëtarëve të vet, me komunat dhe institucionet, duke përfshirë agjencitë qeveritare në Serbi. Një bashkëpunim i tillë mund ta marrë formën e ofrimit nga institucionet serbe të asistencës financiare dhe teknike, duke përfshirë pajisjet,

në zbatimin e kompetencave komunale. Donacionet e mallrave dhe pajisjeve nga Serbia do të përjashtohen nga çdo taksë ose detyrim, në përputhje me legjislacionin në fuqi. E gjithë mbështetja financiare ose tjetër e marrë nga Asociacioni do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe auditimit të Autoriteteve Qendrore siç përcaktohet në këtë Statut dhe ligjin në fuqi. Asociacioni mund të krijojë marrëdhënie dhe të hyjë në marrëveshje bashkëpunimi me asociacione të tjera vendore dhe ndërkombëtare të komunave, autoriteteve lokale, rajoneve dhe njësisive të tjera të vetëqeverisjes lokale në shtetet e tjera. Asociacioni do të angazhohet për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të komunitetit serb të Kosovës. Asociacioni do t'i menaxhojë institucionet arsimore dhe shëndetësore të cilat janë financuar drejtpërdrejt nga Serbia në përputhje me procedurat specifike të përcaktuara në këtë Statut dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. "Rrjeti Arsimor Serb i Kosovës" dhe "Rrjeti Shëndetësor Serb i Kosovës" do të themelohen si ofrues privatë të arsimit dhe shëndetësisë nën përgjegjësinë e Asociacionit, duke theksuar Serbinë si kontribuuesen financiare, si dhe zyrat kryesore të këtyre ofruesve të vendosur

aktualisht në Serbi. Asociacioni do ta menaxhojë funksionimin e këtyre ofruesve të arsimit dhe shëndetësisë. Këto shërbime të lirohen nga doganat dhe të gjitha detyrimet e tjera për aq kohë sa ofrojnë shërbime në interes publik dhe në përputhje me këtë Statut. Në territorin e anëtarëve të Asociacionit këta ofrues mund t'i përdorin objektet publike të krijuara dhe të bashkëfinancuara nga Serbia për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe arsimore. Këto rrjete, gjithashtu, mund të autorizohen për t'i ofruar shërbimet e tyre në territoret e komunave joanëtare. "Rrjeti arsimor serb i Kosovës" do të lëshojë diploma të dyfishta. Dizajni i diplomës (diploma e dhënë nga Kosova) e dhënë nga "Rrjeti arsimor serb i Kosovës", në pajtim me ligjin në fuqi, do të rregullohet me një marrëveshje të veçantë ndërmjet ofruesit dhe autoriteteve kompetente. Institucioni themelues në Serbi do të lëshojë një diplomë dublikatë (diplomë serbe). Vendi i lëshimit të diplomës dublikatë është qyteti (Serbia) ku janë selitë kryesore. Qeveria e Kosovës do ta trajtojë diplomën dublikatë si diplomë të huaj të vlefshme. Asociacioni financon iniciativat lidhur me arsimin - duke përfshirë bursat, trajnimin e mësuesve, grantet kërkimore, zgjidhjet e TI-së, shkëmbimet akademike, programet verore -

për të mirën e avancimit të arsimit midis komunave anëtare. Asociacioni financon projektet ndërtimore dhe infrastrukturore që kanë të bëjnë me ofrimin e arsimit ndërmjet komunave anëtare të saj, si dhe ofrimin e mbështetjes financiare për mirëmbajtjen e arsimit dhe objekteve të lidhura me to (salla sportive, laboratorë IT etj.). Te zhvillimi ekonomik, përpos aspekteve të tjera, Asociacioni do t'i përfaqësojë interesat e anëtarëve dhe aktorëve ekonomikë të vendosur brenda kufirit administrativ të Asociacionit në marrëdhëniet me autoritetet qendrore, si dhe me operatorët e tjerë shtetërorë dhe ekonomikë në rajon dhe më gjerë, duke përfshirë ato nga Serbia. Asociacioni do të përbëhet nga këto organe: a) Kuvendi. b) President dhe zëvendëspresident. c) Bordi. d) Këshilli Këshillëdhënës. e) Administrata. f) Zyra e Ankesave. Kuvendi është organi suprem i Asociacionit. Kryetari dhe zëvendëskryetari zgjedhën nga Kuvendi. Këshilli Këshillëdhënës përbëhet nga maksimumi 30 anëtarë, duke përfshirë të gjithë kryetarët e komunave anëtare. Është organ këshillimor. Bordi i Asociacionit është organ drejtues i Asociacionit dhe përbëhet nga 7 anëtarë. Kryesues i Bordit është kryeshefi ekzekutiv i Asociacionit.

Molliqaj reagon për draftin e Asociacionit: Është i frikshëm, katastrofë

Prishtinë, 12 nëntor - Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka treguar se e ka lexuar draftin e Asociacionit të publikuar

nga Burim Ramadani. Ai thotë se nga shumë burime po del që ky është drafti që u është paraqitur palëve.

"Është i frikshëm. E gjymton funksionimin e shtetit dhe perspektivën e shoqërisë. Asnjë asociacion

nuk është i mirë, por ky që u publikua sot është katastrofë", ka shkruar Molliqaj në "Facebook".





INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI) KA SHPALOSUR VLERËSIMET SE KAH PO SHKON KOSOVA SA I PËRKET LUFTIMIT TË KORRUPSIONIT DHE QEVERISJES DEMOKRATIKE

KDI-ja: Ky vit u përçoll me sulme të vazhdueshme të ekzekutivit ndaj institucioneve të drejtësisë

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur konferencë për medie, në të cilën ka shpalosur vlerësimet lidhur me luftimin e korrupsionit dhe qeverisjen demokratike në Kosovë, bazuar në vërejtjet e Raportit të BE-së për Kosovën për vitin 2023. KDI-ja ka ofruar rekomandime që do të mund ta përmirësonin gjendjen sa i përket luftës kundër korrupsionit, reformës në drejtësi, prokurimit publik, sinjalizimit, punës së Kuvendit të Kosovës dhe dialogut me Serbinë. Për këtë të fundit, KDI-ja ka kërkuar më shumë transparencë nga qeveria. Sa i përket luftës kundër korrupsionit, KDI-ja ka theksuar se qeveria ende nuk ka një vizion të qartë për luftimin e korrupsionit, për faktin që edhe pse kanë kaluar dy vjet qeverisje, ende nuk ka një Strategji Kombëtare Kundër Korrupsionit

Lufta kundër korrupsionit

Eugen Cakolli theksoi se stagnimi në raport me luftimin e korrupsionit buron drejtpërdrejt nga performanca dhe efikasiteti shumë i dobët i gjyqësorit. "Mostrajtimi adekuat i rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë ka ardhur si rezultat i hetimeve joefikase dhe aktakuzave jocilësore nga ana e prokurorisë, si dhe zvarritjeve të trajtimit të lëndëve nga gjykatat. Gjatë këtij viti rastet e korrupsionit janë karakterizuar nga një trend shqetësues i mosdënimit apo parashkrimit. Por, pavarësisht prej dështimeve në trajtimin e rasteve të korrupsionit, llogaridhënia e gjyqësorit dhe prokurorisë është e mangët, që ilustron nga mungesa e vendimeve për shkarkimin e ndonjë gjyqtari apo prokurori për shkak të performancës së dobët", ka theksuar ai.

Në këtë konferencë problem tjetër i sektorit të drejtësisë u tha se mbetet mungesa e konfiskimit të pasurisë së kundërligjshme, ku vërehet një diskrepancë mes pasurisë së sekuestruar dhe asaj të konfiskuar. "Kultura e mosndëshkueshmërisë për vepra korruptive ka bërë që edhe zyrtarë të lartë publik, përfshirë ministra, zëvendësministra, deputetë, ambasadorë e udhëheqës të ndërmarrjeve publike të dyshuar për korrupsion, të vijojnë të mbajnë pozitat e tyre në kundërshtim me parimet themelore të integritetit të qeverisjes, që janë proklamuar vazhdimisht nga qeveria aktuale", është shprehur Cakolli.

Ai ka theksuar se qeveria ende nuk ka një vizion të qartë për luftimin e korrupsionit, për faktin që edhe pse kanë kaluar dy vjet qeverisje, ende nuk ka një Strategji Kombëtare Kundër Korrupsionit. "Çalime serioze ka në zbatimin e Strategjisë për Sundimin e Ligjit dhe Deklaratës së Përbashkët në mes të

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur konferencë për medie, në të cilën ka shpalosur vlerësimet lidhur me luftimin e korrupsionit dhe qeverisjen demokratike në Kosovë, bazuar në vërejtjet e Raportit të BE-së për Kosovën për vitin 2023. Në

konferencë u dhanë rekomandime që do të mund ta përmirësonin gjendjen sa i përket luftës kundër korrupsionit, reformës në drejtësi, prokurimit publik, sinjalizimit, punës së Kuvendit të Kosovës dhe dialogut me Serbinë. Fillimisht u potencua që Raporti i BE-së për Kosovën ka evidentuar pak përparim e shumë sfida dhe mangësi në shumicën prej

fushave, sidomos sa i përket demokratizimit dhe sundimit të ligjit. Për më tepër, stagnimet e evidentuara në raport shpërfaqin një problematikë serioze të Kosovës e cila, pavarësisht prej ndërrimit të qeverisjeve, po ballafaqohet me probleme të përsëritura në raport me vlerat e qeverisjes demokratike, sundimin e ligjit dhe integritetin publik.

Ministrisë së Drejtësisë dhe krerëve të institucioneve të drejtësisë për reformën në drejtësi. Ky vit është karakterizuar nga ndërhyrje dhe sulme të vazhdueshme të ekzekutivit ndaj institucioneve të drejtësisë që janë bërë në forma e për arsye të ndryshme, duke përfshirë uljen e pagave, atakimin e procesit të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, si dhe sulmeve ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për raste gjyqësore”, ka deklaruar ai. Cakolli ka theksuar se luftimi i korrupsionit nuk është mbështetur si duhet as në aspektin e resurseve financiare e njerëzore. Sipas tij, institucionet dhe agjencitë e angazhuara në parandalim dhe luftim të korrupsionit, si Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ndonëse i janë shtuar kompetencat në parandalim të korrupsionit dhe është rritur ndjeshëm numri i subjekteve deklaruese, kjo nuk është përkthyer në shtim të resurseve financiare dhe njerëzore. Ndërsa sa i përket kontrollit financiar të subjekteve politike, u tha që edhe një vit pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri, Zyra për Kontroll Financiar të Subjekteve Politike nuk është konsoliduar në aspektin organizativ, buxhetor apo atë ligjor. Cakolli ka thënë se zyra nuk ka rekrutuar 70 % të stafit dhe ka pasur vetëm tre auditorë për kontroll të raporteve financiare të partive.

Prokurimi publik

Sa i përket luftimit të korrupsionit në shpenzimin e parasë publike, Diana Metushi-Krasniqi shtoi se raporti i BE-së për Kosovën

konfirmon për disa vjet me radhë stagnime serioze në fushën e prokurimit publik duke theksuar se nuk ka përparim në përbushjen e rekomandimeve nga viti në vit. Sipas saj, kapaciteti i dobët i institucioneve për ta administruar prokurimin publik, monitorimin dhe zbatimin e kontratave, si dhe sistemet e dobëta të mjeteve juridike, vazhdojnë të theksohen si një problem për vite me radhë. Për më shumë, ajo thotë se raporti ngre shqetësime për rritjen e theksuar të përdorimit të procedurave të mbyllura.

Tutje thuhet se një theks i veçantë u është vënë shpenzimeve të parave publike përmes procedurave të negociuara pa publikim paraprak në vlerë prej 78.56 milionë eurosh.

KDI-ja ngre shqetësime se përderisa shpenzimet publike përmes prokurimit kanë pësuar ulje të konsiderueshme tre vitet e fundit, përdorimi i kësaj procedure ka treguar një trend të rritjes e që e tejkalon rreth 38 % përdorimin e saj në kohë të pandemisë [2020], e cila në kohë emergjence kishte arritur vlerën prej 56.8 milionë eurosh, respektivisht rreth 21.7 milionë euro më pak.

Metushi-Krasniqi u bëri thirrje institucioneve gjegjëse që urgjentisht ta fillojnë monitorimin dhe kufizimin e përdorimit të panevojshëm të tyre.

Tutje ajo shtoi se Kosova ende nuk e ka përfunduar legjislacionin e saj me acquis të BE-së, nuk ka treguar asnjë zhvillim në fushën e integritetit dhe luftës kundër korrupsionit.

Edhe Agjencia Qendrore e

Prokurimit vazhdon të ketë mungesë të personelit dhe si pasojë ajo nuk siguron ekonomicitetin e shkallës që pritet nga prokurimi i centralizuar. Ajo i bëri thirrje Qeverisë të ndërmarrë hapa konkretë drejt finalizimit të reformës në prokurimin publik që ka filluar qysh më 2019.

Duke iu referuar rëndësisë së sinjalizimit në luftimin e korrupsionit, Albesa Humolli-Geci tha se më 2023 ka pasur avancim të kornizës ligjore për mbrojtjen e sinjalizuesve, por që zbatim praktik i këtij ligji është shumë i mangët, edhe nga institucionet publike edhe nga ato private.

Nga monitorimet dhe intervistat e zhvilluara me zyrtarët e institucioneve publike, KDI-ja ka gjetur se zbatim i këtij ligji në institucionet publike është më tepër i orientuar në drejtim të përbushjes së kërkesave formale ligjore për caktimin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim në institucione sesa që njëmend ka për qëllim ta promovojë sinjalizimin si vlerë për luftimin e korrupsionit në institucionet publike në Kosovë.

Humolli ka theksuar se zyrtarët e institucioneve publike të intervistuar nga KDI-ja kanë deklaruar se korrupsioni është i pranishëm në institucionet publike në Kosovë, mirëpo mungon vullneti si dhe guximi i zyrtarëve për ta denoncuar atë.

Tutje u tha se problematikë në këtë drejtim shihet mungesa e informatave në lidhje me sinjalizimin në institucione publike, duke filluar nga mungesa e informacioneve në lidhje me caktimin e zyrtarit përgjegjës për

sinjalizim - mospublikimi i të dhënave të zyrtarit ku mund të sinjalizohet, kushtet teknike për sinjalizim - mungesa e zyrës dhe frika nga zbulimi i identitetit të sinjalizuesit, mungesa e trajnimeve mbi sinjalizimin dhe mungesa e promovimit të sinjalizimit si vlerë në shërbim të luftimit të korrupsionit në kuadër të institucioneve.

Ajo ka theksuar se Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit si institucion i mandatuar për monitorimin e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e sinjalizuesve duhet të bëjë vlerësime të rregullta dhe monitorim sistematik të zbatimit të kërkesave ligjore nga ana e institucioneve, të zbatojë programe trajnimi për zyrtarët përgjegjës për sinjalizim si dhe të zhvillojë fushat avokimi për ndërgjegjësimin publik të qytetarëve në lidhje me raportimin në interes publik.

Ndërsa u tha se është e domosdoshme të rriten edhe kapacitetet financiare dhe humane të APK-së për ta siguruar përbushjen e mandatit të saj. Në anën tjetër, Humolli shtoi se institucionet publike, përveçse duhet t'i përqafojnë kërkesat ligjore sa i përket mbrojtjes së sinjalizuesve, duhet edhe të kontribuojnë në drejtim të krijimit të një kulture të transparencës, llogaridhënie dhe sjelljes etike brenda institucioneve publike, duke promovuar sinjalizimin si vlerë në luftimin e korrupsionit.

Puna e Kuvendit të Kosovës

Kritikat për punën joefikase të

Kuvendit, përveç të ngritura nga KDI në vazhdimësi, kanë zënë hapësirë të theksuar në raportin për Kosovën.

Mungesat e pajustificuara të deputetëve në seancat parlamentare dhe mbledhjet e komisioneve mbeten problematika kryesore, që po minon efikasitetin e këtij institucioni.

Në mënyrë që Kuvendi të arrijë ta përbushë funksionin e tij, duhet t'i zbatojë mekanizmat në fuqi dhe të krijojë mekanizma shtesë që sanksionojnë sjelljen e papërgjegjshme të deputetëve.

Në rastet kur deputetët mungojnë pa arsye në seanca, Kryesia duhet ta zbatojë Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit për ndalim të kompensimit dhe shpenzimet mujore të deputetëve. Ajo shtoi se Kuvendi sa më parë duhet ta rikthejë votimin elektronik të nevojshëm për fuqizimin e transparencës dhe llogaridhënies.

Dialogu Kosovë - Serbi

Haxholli vijoi tutje edhe me vlerësimet për dialogun Kosovë - Serbi, për të cilat tha se nuk është ofruar transparencë nga ana e qeverisë. Qeveria duhet të ofrojë transparencë ndaj publikut dhe Kuvendit, dhe konferencat për shtyp pas takimeve të dialogut e takimet me liderët politikë nuk mund të jenë zëvendësim për obligimet kushtetuese që qeveria i ka ndaj Kuvendit si institucioni më i lartë mbikëqyrës. Mungesa e informacioneve krijon hapësirë për informacione jozyrtare duke rritur kështu ndjenjën e pasigurisë te qytetarët.



Rruga te rrethi në Lakrishtë, së shpejti lëshohet për qarkullim

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka publikuar fotografi të rrethrotullimit në lagjen Lakrishtë. Siç ka bërë me dije Rama, aktualisht ka mbetur edhe sinjalizimi për t'u vendosur, pastaj të lëshohet

për qarkullim. Sipas tij, kjo rrugë do ta shkarkojë trafikun e ngarkuar në qendër të qytetit. "Ka mbetur edhe sinjalizimi për t'u vendosur dhe rruga nën rrethrotullimin e Lakrishtës po lëshohet për qarkullim. Kjo rrugë do ta

shkarkojë trafikun e ngarkuar në rrugët 'Tirana' e 'Bill Klinton'. Po punojmë pa ndal që të transformojmë Prishtinën, që të kemi infrastrukturën e duhur në kryeqytetin tonë", ka shkruar Rama në "Facebook".



Familjet e prekura nga vërshimet ankohen për vonesë të dëmshpërblimeve



PRISHTINË, 12 NËNTOR - Familjet e prekura nga vërshimet e qershorit të këtij viti në komunën e Pejës tash e pesë muaj nuk i kanë marrë dëmshpërblimet e premtuara nga komuna e tyre e cila ka vlerësuar se dëmet janë me miliona euro.

Edhe pse komuna u kishte premtuar familjeve se do t'u kompensohet i gjithë dëmi, qytetarët ankohen se jo vetëm që nuk kanë marrë ende asgjë, por se edhe vlerësimi i dëmeve ka qenë joreal.

Komuna ka konfirmuar për "KosovaPress" se janë 521 raste

me dëme familjare, biznese dhe automjete, shumë e cila ka arritur mbi 2 milionë euro.

Qytetari nga Peja, të cilit i është dëmtuar e gjithë shtëpia, ka thënë se pas vërshimeve e ka rregulluar shtëpinë që nga fillimi me të gjitha shpenzimet e veta dhe se po pret kompensimin nga komuna. Ai tha se ka shpenzuar mbi 20 000 mijë euro, por se kompensimi nga komuna i takon vetëm shtatë mijë euro, të cilën e konsideron të padrejtë. Edhe qytetari tjetër të cilit i është dëmtuar biznesi nga vërshimet natyrore tha se pas vërshimeve komuna nuk është interesuar

për t'i shpërndarë dëmshpërblimet. Ai tha se edhe sot ka ende makina të punës të cilat ende nuk i ka funksionale. Ndërsa Naser Kollçaku, të cilit i është dëmtuar biznesi familjar, kërkoi nga komuna t'i paguhen dëmshpërblimet sa më shpejt. Drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim në komunën e Pejës, Gëzim Gashi, ka deklaruar se si komunë kanë përmbushur detyrat për t'i dalë në ndihmë familjeve të prekura nga vërshimet. Vërshimet në Pejë, përpos dëmtimeve materiale, përfunduan edhe me persona të vdekur.

Përmirësohet cilësia e ujit në liqenin e Badovcit, së shpejti qytetarët mund ta përdorin për pije

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Është përmirësuar cilësia e ujit në liqenin e Badovcit dhe së shpejti qytetarët mund ta përdorin për pije, ka bërë me dije kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama. Ai tha se kryeshefi ekzekutiv i KRU "Prishtina", Arsim Fetahu, e ka informuar se është përmirësuar cilësia e ujit në liqenin e Badovcit. Ndërsa tregoi se qytetarët brenda pak ditësh do të mund të fillojnë ta përdorin për pije dhe për përgatitje të ushqimeve. "Ju lutem të keni edhe pak

durim, ndonëse e kuptoj shqetësimin që ju keni, sepse z. Fetahu më siguroi që shpejt mund ta konsumojmë ujin sepse tashmë nivelet e manganit në të janë ulur dhe vetëm duhet zbatuar disa procedura të nevojshme që më pas ta përdorim ujin lirshëm për pije", tha Rama.

Ka disa javë që ata të cilët furnizohen me ujë nga ky liqen nuk është rekomanduar të konsumojnë për pije për shkak të nivelit të manganit.



Daka: Gjatë këtij viti kemi pranuar rreth 581 kërkesa për lirim me kusht

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Mbi 580 të burgosur kanë bërë kërkesë për t'u liruar me kusht gjatë këtij viti. Vetëm gjysma e tyre ka përmbushur kriteret ligjore, ndërkohë që Paneli për Lirim me Kusht ka aprovuar kërkesat e rreth 50 për qind të tyre. Kështu tregon kryesuesja e Panelit për Lirim me Kusht, Valdete Daka, e cila deklaroi se ka raste edhe të revokimit të vendimit. Ajo thotë se pas lirimit, personat që kanë kryer veprën penale kanë përsëritur vepra të tilla ose janë larguar nga Kosova pa

paralajmërim. Ajo në intervistën për "Kosovapress" flet edhe për shkruesat që pranojnë nga gratë që mos të aprovohen kërkesat e bashkëshortëve të tyre dhunues për lirim.

Kryesuesja e Panelit për Lirim me Kusht, Valdete Daka tregon për vlerësimet që bëjnë për personat që kërkojnë lirim. I dënuari ka të drejtë që sa herë që e arrin kushtin të paraqesë kërkesën për lirim me kusht, por një pjesë të dënimit duhet ta vuajë në burgim.

Haradinaj nderon dëshmorët britanikë të rënë në Kosovë

Prishtinë, 12 nëntor - Britania e Madhe dhe Commonwealth-i të dielën kanë shënuar Aktin e Përkujtimit Njëqindvjeçar për të gjithë të rënë e tyre në të

gjitha luftërat që nga Lufta e Parë Botërore. Në kujtim të heroizmit të këtyre luftëtarëve përgjatë një shekulli, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka vendosur kurorë me lule

pranë Memorialit të Dëshmorëve Britanikë në sheshin "Edith Durham" në kryeqytet. "Përkulemi me nderim para sakrificës të të gjithë të rënëve britanikë,

veçanërisht atyre që kanë rënë në Kosovë. Ishim miq në kohë lufte dhe miqësia jonë vazhdon të jetë po aq e fortë edhe në kohë paqeje!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



Shtohen paratë false në tregun e Kosovës



PRISHTINË, 12 NËNTOR - Shtim masiv i parave false në tregun e Kosovës. Kështu e përshkruajnë ekspertët e Agjencisë së Forenzikës praninë e monedhave dhe kartëmonedhave të falsifikuara në vend.

Vlera e tyre, thonë ata, është në rritje krahasuar me vitin e kaluar, aktualisht dhjetëra mijëra euro. Nga janari deri në shtator të vitit 2023 në laboratorin e Agjencisë së Forenzikës u ekzaminuan mbi 35 000 monedha të falsifikuara dhe 2 209 kartëmonedha të falsifikuara. Në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ekspertët e forenzikës ekzaminuan 9 309 monedha të falsifikuara dhe 645 kartëmonedha.

Më të falsifikuarat, sipas tyre, janë monedha prej 2 eurosh dhe kartëmonedha prej 50 eurosh.

Feriz Selimaj, ekspert në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, thotë për "Radion Evropa e Lirë" se cilësia e falsifikimeve varion nga më e dobët deri në shumë e mirë. "Për ne si ekspertë nuk është vështirë të identifikohen [paratë false]. Është e thjeshtë. Në laborator kemi aparaturë të avancuar dhe identifikohen lehtë, por për një qytetar nuk është e lehtë të dallohet origjinali me falsin", thotë Selimaj.

Kosova nuk është pjesë e Eurozonës, por përdor euron. Nga shtetet e tjera të rajonit, ashtu vepron edhe Mali i Zi.

Në korrik të këtij viti, "REL"-i raportoi për së paku dy raste të

konfiskimit të mijëra eurove të falsifikuara në Kosovë që vinin nga Maqedonia e Veriut dhe Turqia.

Për raportimin e atëhershëm, "REL"-i bisedoi edhe me disa profile në aplikacionin TikTok, që konfirmuan se mund të sjellin para false në Kosovë, në çfarëdo shume që kërkohet, por nuk porositi për të mos kryer vepër penale.

Policia e Kosovës atëkohë nuk iu përgjigj pyetjes së "REL"-it nëse i ka hetuar profilet e tilla ose personat që pretendojnë se i menaxhojnë ato.

Qindra raste të iniciuara në polici

Me Kodin Penal të Kosovës, kushdo që prodhon, vë në qarkullim, transporton, pranon, përdor ose ka para të falsifikuara, me qëllim që t'i vendosë në qarkullim si të vërteta, dënohet prej 1 deri në dhjetë vjet burgim. Sipas të dhënave që "Radio Evropa e Lirë" siguroi nga Policia e Kosovës, në gjashtë muajt e parë të këtij viti u iniciuan 486 raste të falsifikimit të parave, ndërsa gjatë gjithë vitit të kaluar 804.

Çfarë thotë Banka Qendrore e Kosovës?

Në një deklaratë me shkrim dhënë "REL"-it, Banka Qendrore e Kosovës thotë se është duke u koordinuar me organet

përgjegjëse "për t'i mbështetur në veprimet e tyre për kufizimin dhe parandalimin" e dukurisë së parave false. Pa dhënë më shumë detaje, në BQK thonë se paratë false e dëmtojnë ekonominë e Kosovës dhe i inkurajojnë sidomos bizneset ta ndalojnë praktikën e furnizimit me monedha nga "operatorë të dyshimtë" dhe për çdo kërkesë t'u drejtohen bankave komerciale. Ata nuk specifikojnë se kujt i referohen me "operatorë të dyshimtë", por thonë se praktika e tillë do të kontribuonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në parandalimin e qarkullimit të parave false.

Më 7 nëntor BQK-ja i njoftoi mediet për mbajtjen e një takimi ndërinstucional lidhur me luftimin e kësaj dukurie.

Në komunikatë u tha se "Banka Qendrore e Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia e Kosovës për Forenzikë, Doganat e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Njësia e Intelgjencës Financiare, Inspektorati i Tregut dhe Agjencia e Kosovës për Intelgjencë janë pajtuar t'i intensifikojnë aktivitetet në zbatim të ligjit, të shtohen kontrollat dhe aktivitetet inspektuese brenda dhe në kufi, si dhe të ndiqen ligjërisht dhe me efikasitet aktivitetet e tilla joligjore".

"REL"-i bisedoi me përfaqësues të disa bizneseve të vogla në Prishtinë dhe disa prej tyre pranuan se janë përballur me monedha false, kryesisht dy euro. "Disa konsumatorë duan të blejnë

me ato para se nuk e dinë që janë false, por ka pasur raste që edhe unë kam pranuar 2 euro false dhe nuk e kam ditur", tha pronari i një biznesi ushqimor, duke dashur të mbetet anonim. "Të ta them të drejtën, edhe marr para false, por edhe kthej. Ka shumë në qarkullim, më së shumti 2 euro", tha ai.

Çfarë thonë ekspertët?

Falsifikimi i parasë është krim që në mënyrë të vazhdueshme paraqet rrezik për ekonominë e një vendi, thonë ekspertët të çështjeve financiare. "Në momentin që identifikohen si para false, aq sa është shuma e tyre, aq janë edhe humbjet në ekonomi", thotë Milazim Abazi, ish-kryesues i Komitetit të Financave në Odën Ekonomike Amerikane.

Nga 1 janari i vitit të ardhshëm qytetarët e Kosovës pritet të lëvizin pa viza në vendet e BE-së, gjë që pritet ta rrisë edhe qarkullimin e tyre. Por, cili është rreziku që ata të përballen me shkelje nëse bartin pa ditur para false në tregun e BE-së? "Unë do t'i këshilloja qytetarët e Kosovës që të mos marrin monedha metalike se mund të përballen me përgjegjësi ligjore nëse i prezantojnë ato para në vendet e BE-së", thotë Abazi.

Mejdi Bektashi, profesor i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, nuk sheh ndonjë rrezik të madh në këtë aspekt. "Shumica e njerëzve përdorin kartelat

bankare për t'i ikur këtij rreziku. Të gjitha këto para false, në fund, do të mbesin në Kosovë", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë".

Si të mbroheni nga paratë e falsifikuara?

Për kontrollin e vërtetësisë së parave, Banka Qendrore e Kosovës sugjeron qytetarët që të ndjekin tre hapa të lehtë: "prek, shiko, kontrollo", pa pasur nevojë për mjete të posaçme.

Monedhat false janë zakonisht më të vrazhda dhe mund të identifikohen edhe me devijime, shkronja dhe simbole që nuk përputhen me origjinalin.

Kontrollimi i vërtetësisë së monedhave, sipas sugjerimeve të BQK-së, mund të bëhet edhe me ndihmën e një magneti, sepse prerjet e ndryshme kanë veti magnetike të ndryshme nga njëra-tjetra. "Te monedhat 1 dhe 2 euro, të cilat janë bimetalike, pjesa e brendshme është pak magnetike, ndërsa pjesa e jashtme jo. Monedhat 1, 2 dhe 5 centë janë shumë magnetike dhe tërhiqen lehtësisht nga magneti. Monedhat e falsifikuara, nga ana tjetër, zakonisht ose nuk janë fare magnetike, ose tërhiqen fort nga magnetet", thuhet në manualin e BQK-së për mbrojtje nga paratë false.

Selimaj, nga Agjencia e Forenzikës, i sugjeron qytetarët t'i përdorin më shumë kartelat bankare.

Kurti gjatë takimeve në Paris flet për mundësitë e bashkëpunimit në fushën e energjisë

Prishtinë, 12 nëntor - Qëndrimin në Paris kryeministri Albin Kurti e ka vazhduar me takimin me drejtorin ekzekutiv të Qendrës Ndërkombëtare për Bashkëpunim Ekonomik dhe Social (C.I.C.E.S), Michael Deboudt, presidentin e Bordit, Jean Reveillon dhe

anëtarin tjetër të Bordit, Bernard Miyet.

Zyra e kryeministri njofton se në takim është diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit në fushën e energjisë. "Aty u bisedua për mundësitë e bashkëpunimit në fushën e energjisë, tregtisë, investimeve, akademisë

përmes programeve të ndryshme të shkëmbimit, dhe artit". Duke folur për raportet dhe partneritetin ndërmjet dy vendet, ndër të tjera, në takim kryeministri veçoi bashkëpunimin e mirë që Kosova ka me Francën në fushën e filmit dhe rezultat e deritanishme.



Gjykata ia refuzon kërkesën Ben Emmersonit, raporti i Fred Abrahams mbetet provë në gjykimin e krerëve të UÇK-së



Raporti i Human Rights Watch i hartuar nga Fred Abrahams do të mbetet si provë në gjykimin e krerëve të UÇK-së. Pavarësisht ankesës së avokatit të Kadri Veselit, Ben Emmerson, trupi gjykues ka vendosur që nuk ka bazë që ky raport të përjashtohet nga provat. Nacionale sjell detaje.

U konfirmua nga vetë Fred Abrahams që në raportin e tij kishte përdorur të dhëna e informacione nga Qeveria e mediat e Serbisë. Por, pavarësisht kësaj publikimi i Human Rights Watch do të mbetet si prove në gjykimin e krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Trupi gjykues në Hagë e ka refuzuar kërkesën e avokatit Ben Emmerson që ky raport të përjashtohet nga provat e pranuar në procedure.

Në vendimin që e ka parë Nacionale, thuhet se nuk është krijuar asnjë situatë e jashtëzakonshme që do ta arsyetonte përjashtimin e raportit nga provat.

“Paneli thekson më tej se Mbrojtjes Veseli iu dha kohë e mjaftueshme për të marrë në pyetje dëshmitarin, duke përfshirë në lidhje me metodologjinë dhe burimet e përdorura nga HRW në

përpilimin e P380. Mbrojtja e Veselit argumenton se fakte dhe rrethana të reja dolën gjatë marrjes në pyetje të tërthortë të W04408, të cilat përbënin rrethana të jashtëzakonshme që garantojnë rishqyrtimin e Vendimit të kundërshtuar për të shmangur një padrejtësi. Paneli nuk pajtohet. Asgjë e nxjerrë gjatë marrjes në pyetje të kryqëzuar nuk ka ndikuar në asnjë nga kërkesat e Rregullit 138(1) në lidhje me pranueshmërinë e këtij artikulli”, thuhet në vendimin e gjyqtarëve të Speciales.

“Paneli vëren se, përderisa bie në prerogativën e mbrojtjes që të kundërshtojë provat përmes marrjes në pyetje të tërthortë, pohimi i thjeshtë se besueshmëria e një prove të pranuar është minuar gjatë marrjes në pyetje të tërthortë nuk e plotëson pragun e Rregullës 79. Paneli prandaj nuk është bindur se provat e nxjerra nga W04408 nga Mbrojtja Veseli në mbështetje të qëndrimit të saj se P380 merret kryesisht nga burime dytësore, përbën një rrethanë të jashtëzakonshme që kërkon që Paneli të rishqyrtojë Vendimin e kundërshtuar për të shmangur dëmtimin e pariparueshëm ndaj të drejtave të z. Veseli për gjykim të drejtë”,

thuhet më tutje.

Megjithatë, për rëndësinë e këtij raporti, trupi gjykues do të vendosë krejt në fund të gjykimin, kur vlerësohen të gjitha provat, raportin Nacionale.

“Ky artikull, si të tjerët, do t’i nënshtrohet vlerësimit të kujdesshëm të Panelit për peshën dhe vlerën e tij provuese në dritën e provave në tërësi. Për këto arsye, Paneli konkludon se Mbrojtja Veseli ka dështuar të dëshmojë se Paneli ka kryer një gabim të qartë të arsyetimit në pranimin e raportit ose, në dritën e marrjes në pyetje të tërthortë të W04408, është shkaktuar një padrejtësi që garanton rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të Vendimit të kundërshtuar”, përfundon vendimi.

Kjo është vetëm një nga kërkesat e mbrojtjes që rrëzohen nga trupi gjykues, ashtu siç ka ndodhur me mbi 90% të të gjitha kërkesave deri më tash.

Por, cila ishte kërkesa e Emmersonit?

Raporti i hulumtuesit të Human Rights Watch, Fred Abrahams, për vrasjet e pretenduara të civilëve nga Ushtria Çlirimtare e

Kosovës, ishte pranuar si provë në gjykimin e krerëve të UÇK-së në Hagë. Megjithatë, pas dëshmisë së Abrahams fizikisht në sallën e gjyqit, mbrojtja e krerëve të UÇK-së po kërkon që kjo prove të përjashtohet nga procesi.

Sipas avokatit të Kadri Veselit, Ben Emmerson, për hartimin e këtij raporti që është si prove në gjykim, dëshmitari Abrahams e ka pranuar edhe vetë që ka përdorur raporte nga mediat serbe dhe komunikata nga Qeveria e Serbisë.

Në parashtrimin që e ka bërë Emmerson me përkrahjen edhe të avokatëve të tjerë të krerëve të UÇK-së, thuhet se i gjithë raporti është hartuar me burime dytësore e tretësore.

Sipas parashtrimin të Emmerson, vetë dëshmitari në përgjigjet e tij e konfirmon se raporti u mbështet kryesisht në mediat e Beogradit.

“Veçanërisht, megjithatë, kur u përball me faktin se burimi i vetëm në të cilin FDH u mbështet për një pretendim që ishte ricikluar në P380 ishte “Media e Beogradit”, dëshmitari vërejt se ai nuk mund të fliste për FDH-në ose vendimet që ata morën në lidhje me burimet.39 Në të vërtetë, ky koncesion është pikërisht arsyeja pse Mbrojtja

parashtron se kërkohej një vlerësim i pavarur i burimeve të tyre, pavarësisht se sa e itua ishte marrëdhënia profesionale midis dy organizatave ose individëve të përfshirë”, thuhet në kërkesën e Ben Emmerson.

Avokati i Kadri Veselit që e kishte marrë në pyetje për orë të tëra Abrahamsin, tregoi në detaje se shumica e këtij raporti ndërtohej pa intervista me dëshmitarët apo viktimat.

“Në total, P380 përmban 34 citate. Midis tyre, vetëm tre citate i referohen intervistave ose bisedave që ka kryer vetë personeli i HRW – asnjëri prej të cilëve nuk është viktimë apo dëshmitar i krimeve. Media – private dhe shtetërore – si dhe jo -Organizatave qeveritare përbëjnë shumicën dërrmuese, nëse jo të gjitha, të referencave të përfshira në P380. Veçanërisht, 11 referenca i janë bërë raportit të lartpërmendur të FDH Spotlight nga 5 gusht 1998, i cili, nga ana tjetër, citon burime të tjera dytësore, duke përfshirë vetë “FDH” dhe “Medien e Beogradit””, thuhet në këtë kërkesë të Emmerson.

Kërkesën e kishte kundërshtuar Prokuroria e Specializuar, e cila fitoi këtë betejë, pasi trupi gjykues i dha të drejtë, edhe kësaj radhe, Prokurorisë.

Shpresa e fundit

Harriet SHERWOOD

“Dita pas luftës” midis Izraelit dhe Hamasit në Gaza mund të jetë ende javë apo muaj larg. Por do të vijë. “Kur kjo krizë të marrë fund, duhet të ketë një vizion për atë që do të vijë më pas,” tha presidenti amerikan Joe Biden kohët e fundit. “Dhe sipas këndvështrimit tonë, duhet të jetë një zgjidhje me dy shtete.”

Në sfondin e cikleve të përsëritura të dhunës dhe një pushtimi ushtarak që zgjat më shumë se gjysmë shekulli, diplomatët dhe analistët pajtohen se paqja e qëndrueshme duhet të pasojë luftimet më të përgjakshme midis izraelitëve dhe palestinezëve në disa dekada.

Zgjidhja me dy shtete për konfliktin që ka pllakosur rajonin për gati një shekull – ndarja e tokës midis lumit Jordan dhe Mesdheut për të krijuar dy shtete, Izraelit dhe Palestinez, që bashkëjetojnë në fqinjësi – është mbështetur vazhdimisht nga udhëheqësit botërorë.

Por ka rezultuar e pamundur që Izraeli dhe palestinezët të arrijnë një marrëveshje. Dhe, që kur bisedimet e ndërmjetësuar nga John Kerry, atëherë sekretari amerikan i shtetit, u ndalën në vitin 2014, e teksa vendbanimet hebraike në Bregun Perëndimor dhe Jeruzalemin Lindor janë zgjeruar, konsensusi ka qenë se zgjidhja me dy shtete ka “vdekur”. Kjo pikëpamje është përforcuar nga sondazhet e opinionit të kryera pak para sulmit vdekjeprurës të Hamasit ndaj qytetarëve izraelitë më 7 tetor. Në shtator, një studim i Qendrës Kërkimore Pew zbuloi se vetëm 35% e izraelitëve besonin se “mund të gjendet një mënyrë që Izraeli dhe një shtet i pavarur palestinez të bashkëjetojnë në mënyrë paqësore” – një rënie prej 15 pikë përqindjeje që nga viti 2013.

Dhe një sondazh i Gallup zbuloi se vetëm 24% e palestinezëve që jetonin në Bregun Perëndimor, Gaza dhe Jeruzalemin Lindor mbështesin një zgjidhje me dy shtete, nga 59% në që ishin në vitin 2012. Të rinjtë palestinezë ishin dukshëm më pak entuziastë se prindërit e tyre.

A mund të ringjallet zgjidhja me dy shtete? Dhe, duke pasur parasysh luftën e vazhdueshme, tensionet rajonale dhe praninë e kolonëve në atë që do të ishte një shtet palestinez, si mund të duket ajo?

“Nuk ka alternativa të tjera të mundshme,” thotë Yossi Mekelberg, një bashkëpunëtor në qendrën Chatham House. “Zgjidhja me dy shtete është

alternativa më pak e keqe për t’u mundësuar izraelitëve dhe palestinezëve të përmbushin të drejtat e tyre politike, civile dhe njerëzore.”

Yossi Beilin, një ish-negociator izraelit për paqen, thotë: “Kjo është zgjidhja e vetme – nuk ka konkurrencë realiste”.

Por sipas Aaron David Miller, këshilltar për Lindjen e Mesme për administratën demokratike dhe republikane, “duhet të bëjmë dallimin midis aspiratës dhe realitetit”. Ai gjithashtu paralajmëroi: “Shanset janë shumë, shumë të ulëta. Është në thelb një mision i pamundur”.

Ka shumë pengesa në rrugën e një zgjidhjeje me dy shtete, thotë Miller. Menjëherë pas luftës, “do të mbeten dy shoqëri thellësisht të traumatizuara”.

Qeveria e ekstremit të djathtë të Izraelit është kundër idesë së një shteti të pavarur palestinez dhe udhëheqësi i saj, Benjamin Netanyahu, ka bllokuar përparimin në këtë çështje për shumë vite. Pak presin që ai të mbijetojë si kryeministër pasi të përfundojë lufta, por nuk ka asnjë alternativë të dukshme pro paqes.

Autoriteti Palestinez, i udhëhequr nga Mahmoud Abbas, i cili ka munguar kryesisht në skenë muajin e kaluar, nuk ka besueshmëri në publik. Abbas është 87 vjeç dhe mandati i tij katërvjeçar si president, deri më tani ka zgjatur gati 19 vjet.

Pasardhësi i tij i vetëm i besueshëm, Marwan Barghouti, një udhëheqës i lartë i fraksionit politik Fatah dhe hero për shumë palestinezë, ka qenë në një burg izraelit për 21 vjet, duke vuajtur pesë dënime të përrjetshme për vrasje.

“Ai që mungon nga të dyja palët është lidhshipi dhe vullneti politik. Të dyja palët duhet të zgjohen pas kësaj lufte të tmerrshme dhe të gjejnë lidhshipi të ri”, thotë Mekelberg.

Në SHBA, tradicionalisht drejtuese e procesit të paqes në Lindjen e Mesme, energjitë e Bidenit do të përthithen pashmangshmërisht nga lufta për të mbajtur presidencën e tij gjatë 12 muajve të ardhshëm. Nëse ai humbet përballë Donald Trump, shanset për të ringjallur zgjidhjen me dy shtete janë afër zeros.

Shtetet arabe, të cilat do të ishin aktore vendimtare në çdo proces, mund të frenohen nga zemërimi i popullatës së tyre, për një numër të madh viktimash civile dhe një krizë të humanitare në Gaza.

Dhe edhe nëse Izraeli, palestinezët, SHBA-të dhe vendet arabe do të ishin të vendosur për të çuar përpara një proces të ri paqeje, sfidat kryesore të çdo



marrëveshjeje – kufijtë dhe vendbanimet izraelite në Bregun Perëndimor dhe Jeruzalemin Lindor, e ardhmja e Jeruzalemit, “E drejta e kthimit” e refugjatëve palestinezë dhe pasardhësve të tyre, siguria dhe Gaza – janë ende në tryezë.

Megjithatë, parimet për një marrëveshje janë pranuar për shumë vite, thotë Hiba Hussein, avokate palestineze me banim në Ramallah. “Ne e dimë se si duket një zgjidhje me dy shtete.”

Ajo dhe Beilin kanë bërë një propozim për një konfederatë izraelito-paltestineze – një “bashkëjetesë e dy shteteve sovraane” – për të trajtuar një sërë detajesh.

Disa vendbanime hebraike afër “vijës së gjelbër” të para vitit 1967 – linja e marrëveshjes së armëpushimit të vitit 1949, që pasoi shpalljen e shtetit të Izraelit në 1948 – do të përfshiheshin në Izrael, me kompensim shkëmbim të tokës për një shtet të ri palestinez; një parim i pranuar gjerësisht nga të gjitha palët.

Sipas planit të konfederatës, izraelitët që jetojnë në vendbanime më të thella në Bregun Perëndimor do të jenë në gjendje të zgjedhin nëse do të zhvendosen në shtëpi brenda Izraelit apo do të qëndrojnë aty ku janë si qytetarë izraelitë, por banorë të përhershëm të Palestinës, duke rënë dakord të respektojnë ligjet e shtetit të ri. Një numër qytetarësh palestinezë do të mund të lëvizin në Izrael, me të njëjtat kushte.

Qyteti i Vjetër i Jeruzalemit, shtëpia e vendeve të shenjta të rëndësishme myslimane, hebraike dhe të krishtera, do të bëhej një “qytet i hapur”, i administruar së bashku nga të dy shtetet. Qyteti i hapur më vonë do të zgjerohet për të përfshirë të gjitha lagjet e tij hebreje dhe myslimane.

Gaza “nuk mund të lihet jashtë” nga një shtet i ardhshëm

palestinez, thotë Hussein. Do të duhet të ketë korridore tokësore midis Bregut Perëndimor dhe Gazës për të lejuar aksesin, por “tashmë ka plane për ta”.

Sipas këtyre planeve ekzistuese, një shtet palestinez do të kishte një forcë policie, por jo një ushtri apo forcë ajrore; dhe një numër simbolik i pasardhësve të refugjatëve palestinezë do të lejoheshin të ktheheshin për të jetuar në Izrael.

Parimi i dy shteteve që jetojnë krahas krahas është “jo vetëm i mundshëm, por edhe kritik”, thotë Hussein. “Para kësaj lufte, ekzistonte një politikë e ‘menaxhimit’ të konfliktit. Tani është e qartë se ishte një politikë e dështuar.”

Ndërkohë, zgjidhja me një shtet ka marrë vrull, veçanërisht në mesin e palestinezëve dhe mbështetësve të tyre, në mungesë të ndonjë lëvizjeje drejt një shteti palestinez krahas një shteti izraelit.

Ideja është në thelb që një shtet demokratik të ekzistojë në tokën që tani është Izraeli dhe territoret palestineze, me vota të barabarta për të gjithë. Por në mënyrë të pashmangshme do të nënkuptonte fundin e shtetit hebre, pasi hebrejtë do ishin brenda popullsisë së një shteti të vetëm.

Numrat tashmë janë të pabarabartë. Sipas byrosë izraelite të statistikave vitin e kaluar, hebrejtë përbënin 74% të popullsisë izraelite, me 7 milionë banorë. Popullsia arabe e Izraelit ishte 21%, ose pothuajse 2 milionë. Këtë vit, Byroja Qendrore Palestineze e Statistikave e vlerësoi popullsinë e Bregut Perëndimor dhe Gazës në pothuajse 5.5 milionë.

Kur i shtohen 2 milionë palestinezët që jetojnë në Izrael, totali është gati 7.5 milionë – më shumë se popullsia hebreje e Izraelit. Dhe popullsia palestineze është dukshëm më e re dhe për këtë arsye po rritet më

shpejt.

Zgjidhja me një shtet është jorealiste, thotë Yehuda Shaul, bashkëthemelues i Ofek, një institut i pavarur izraelit i përkushtuar për të çuar përpara një zgjidhje me dy shtete. “A mund ta shihni një realitet në të cilin hebrejtë izraelitë heqin dorë nga hegjemonia demografike brenda vijës së gjelbër dhe vendosin të ndajnë tokën dhe të bëhen pakicë?”

Por, ai shton: “A besoj se zgjidhja me dy shtete është afër? Jo. A besoj se projekti kombëtar i shtetit të Izraelit është të parandalojë një rezultat me dy shtete? Po.”

Publiku palestinez shpejt do të ripërfaqonte një zgjidhje me dy shtete, thotë Hussein. “Opinionin në rrugë i përgjigjet asaj që përdodh. Humori pasqyron momentin, dhe tani momenti është shumë i errët. Por nëse kemi një horizont ku mund të shohim një fund të lojës, humori do të ndryshojë.”

BE-ja ka thënë se është “gati të kontribuojë në ringjalljen e një procesi politik mbi bazën e zgjidhjes me dy shtete”. Ajo ka bërë thirrje për një konferencë paqeje që do të mbahet brenda gjashtë muajve nga përfundimi i luftës.

“Paqja nuk do të vijë vetvetiu; ajo duhet të ndërtohet”, tha Josep Borrell, shefi i politikës së jashtme të BE-së. “Zgjidhja me dy shtete mbetet e vetmja e zbatueshme që ne njohim. Dhe nëse kemi vetëm një zgjidhje, duhet t’i kushtojmë të gjithë energjinë tonë politike për ta arritur atë.”

Shumica e vëzhguesve pajtohen se nevojitet një udhëheqje e freskët dhe e guximshme politike nga të dyja palët. “Të dyja palët do të duhet të bëjnë llogaritë,” thotë Miller. “Ajo që nevojitet është një [Nelson] Mandela dhe një [FW] De Klerk, ose dikush i ngjashëm. Liderë mund të dalin sërish – shikoni [presidentin ukrainas Volodymyr] Zelenskiy.

Sipas Beilin, me lidhshipi dhe vullnet politik, një marrëveshje kuadër mund të arrihet relativisht shpejt: “Jo pak javë, por në një vit është e mundur,” tha ai. Mbështetja publike do të pasonte direkt.

Ai shton: “Në prag të Oslos [marrëveshjeve historike të paqes të 1993], pati kundërshtim të plotë ndaj çdo kontakti me PLO [Organizata për Çlirimin e Palestinës]. Pasi u firmos marrëveshja, pati një mbështetje të madhe. Dhe unë besoj se, nëse mund të arrihet një marrëveshje pas kësaj lufte, do të ketë gjithashtu mbështetje të madhe.” Observer – Bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Invert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Prishtina barazon me Lirinë, Drita e Llapi fitojnë në shtëpi

PODUJEVË, 12 NËNTOR - Prishtina ka arkëtuar një pikë në duel me rivalin e vjetër, Lirinë, në kuadër të javës së 14-të në Albi Mall Superligë. Ndashja e zhvilluar në stadiumin "Përparim Thaçi", u mbyll me shifrat 2-2. Bardhekaltrit e

kryeqytetit patën fillim të furishëm, duke krijuar epërsi prej dy golash përmes Blesas (3') dhe Kryeziut (9'). Megjithatë, në pjesën e dytë skuadra prizrenase shfaqti lojë dukshëm më të mirë dhe arriti të shënojë dy gola përmes

Stafës (75') dhe Megamenos (83'). Prishtina mbetet në vendin e pestë me 18 pikë, kurse Liria është e fundit me 9 sosh. Ndërkohë, Drita ka marrë pikët e plota në duel me Fushë Kosovën (1-0). Golin e fitores e realizoi Besnik

Krasniqi (84'). Me të njëjtin rezultat fitore ka shënuar edhe Llapi ndaj Feronikelit '74. Hamdi Namani (29') shënoi golin e tri pikëve të rëndësishme të llapjanëve. Pas kësaj fitore, Llapi ka 25 pikë aq sa ka edhe Drita.



Kosova triumfon kundër Izraelit

Futbollistët "dardanë" të dielën në mbrëmje e kanë gjunjëzuar Kombëtaren e Izraelit, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri". Pas kësaj fitore, Kosova është motivuar për dy ndeshjet e radhës ndaj Zvicrës dhe Bjellorusisë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 NËNTOR - Përfaqësuesja e Kosovës e ka gjunjëzuar Kombëtaren e Izraelit në ndeshjen që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri", pasi e mposhti me rezultat 1-0. Përballja e Kosovës me Izraelin është në kuadër të grupit I kualifikues për Evropianin e vitit të ardhshëm që do të mbahet në Gjermani. Kjo ndeshje ishte paraparë të zhvillohej në tetor, por u shty shkaku i situatës në Lindjen e

Mesme. Autori i golit të fitores, Milot Rashica ka thënë se "dardanët" e kanë merituar fitoren në këtë ndeshje. "Jam shumë i lumtur për fitoren e sotme. Mendoj se kemi luajtur shumë mirë dhe e kemi merituar fitore. Jam përshtatur në pozitën e re në fushë. Një nga pozitë e që më përshtatet është ajo prapa sulmuesit dhe çdo gjë po shkon mirë në ndeshjet e fundit", ka thënë Rashica. "Dardanët" luajtën më mirë në pjesën e parë dhe arritën të gjejnë rrugën e golit në minutën e 41-të, kur Muriqi me



kokë asistoi për Rashicën dhe ky i fundit pas një depërtimi realizon për 1-0. Rashica pati edhe një rast në pjesën e parë të ndeshjes që nuk e shfrytëzoi. Në anën tjetër, Izraeli nuk e pati ndonjë rast serioz në pjesën e parë. Kosova shkeli edhe në pjesën e dytë, por pa

mundur të realizon golin e dytë. Zëvendësuesi Zymer Bytyqi u shërbye mirë nga Rashica, por gjuajtjen e tij e ndali portieri mysafirë. Më pas tentuan të shënojnë edhe Rashica dhe Muriqi, por pa sukses. Rast të mirë pati edhe Ermal Krasniqi që nuk

arriti të shënon gol, derisa dy raste i patën edhe izraelitët që nuk ishin edhe aq shumë serioze. Duhet theksuar se në këtë ndeshje titullar dhe paraqitje pozitive patën tre futbollistët e Superligës, Lumbardh Dellova, Ilir Krasniqi dhe Qëndrim Zyba. "Më herët është menduar se futbollistët e Superligës nuk mund të luajnë në kombëtare, por ja sonde ata luajtën dhe e fituam lojën", u shpreh trajneri i Kosovës, Primozh Gliha. Pas tri pikëve të reja, "Dardanët" janë në pozitën e katërt me 10 pikë. Në anën tjetër, Izraeli është një pozitë me lartë me vetëm një pikë me shumë se "dardanët". Kosova dy ndeshjet e fundit të këtij cikli kualifikues i zhvillon kundër Zvicrës, më 18 nëntor në Bazël dhe kundër Bjellorusisë, më 21 nëntor në "Fadil Vokrri".

Fitojnë Prishtina dhe Trepça

PRIZREN, 12 NËNTOR - Sigal Prishtina mundi Proton Cable Prizrenin me rezultat 91:109 (26:26, 24:23, 20:32, 21:28), në ndeshjen që u zhvillua në kryeqytet. Prishtina e nisi me një seri 2:10, por prizrenasit u rikthyen shpejt dhe barazuan shifrat, ndërsa në çerekun e parë herë njëra skuadër e herë tjetra kalonte në epërsi deri kjo pjesë përfundoi 26:26. Edhe në periudhën e dytë u zhvillua lojë e baraspeshuar, ku skuadrat shkuan në pushim 50:49. Megjithatë, prishtinasit ishin më të mirë në periudhën e tretë, 20:32 dhe atë të fundit 21:28 për të triumfuar në fund 91:109. Te prizrenasit u dalluan Ty Cockfield me 22 pikë e tetë kërcime, Desi Sills



me 18 pikë e dhjetë kërcime dhe Musab Mala me 18 pikë, katër

kërcime e katër asistime, ndërsa te prishtinasit u dalluan Shaheed

Davis me 22 pikë e dhjetë kërcime, Derrick Wilson me 16 pikë, shtatë kërcime e tetë asistime, Dardan Berisha me 18 pikë, gjashtë kërcime e katër asistime. Sigal Prishtina është e treta me pesë fitore e tri humbje, ndërsa Proton Cable Prizreni i shtati me dy fitore e gjashtë humbje. Trepça ka shënuar fitore ndaj Istogut me rezultat 112:82 (23:23, 25:25, 37:14, 27:20), në javën e tetë të Prince Caffè Superligës, ku dallimi u bë në pjesën e dytë. Në fakt pjesa e parë ishte tërësisht e barabartë, madje istogasit e nisën më mirë ndeshjen, sidoqoftë, mitrovicasit nuk lejuan shkëputjen e tyre dhe pjesa e parë përfundoi 48:48. Megjithatë,

vendasit u mobilizuan në periudhën e tretë, ku ishin bindshëm më të mirë, si në sulm, ashtu edhe në mbrojtje, duke e fituar këtë pjesë 37:14, ndërsa në dhjetë minutat e fundit vetëm sa shtuan epërsinë dhe triumfuan 112:82. Te vendasit u dalluan Drilon Hajrizi me 34 pikë, gjashtë kërcime e katër asistime dhe debutuesi Darnell Edge me 22 pikë, shtatë kërcime e dhjetë asistime, kurse te mysafirët më i miri ishte Arian Azemi me 25 pikë, pesë kërcime e nëntë asistime. Trepça numëron gjashtë fitore e dy humbje, duke u renditur e dyta, kurse Istogu me një fitore e shtatë humbje është në vendin e fundit në tabelë.

Tetë gola në derbin Chelsea - City

LONDËR, 12 NËNTOR - Chelsea dhe Manchester City janë ndarë në barazimin fantastik 4-4 në "Stamford Bridge", ku merita e gjitha për skuadrën e Chelsea ishte Armando Broja në shtesa, pasi fitoi një penallti e cila u ekzekutua në gol. Pjesa e parë ishte fantastike, ku 45'

minutat e para përfunduan me rezultat 2-2. Të parët shënuan miqtë me Haaland, por u barazuan menjëherë nga Thiago Silva. Më pas, Chelsea kalon në avantazh me anë të Sterling në fundin e pjesës së parë. Në të dytën, Haaland kalon menjëherë në epërsi City

nga pika e bardhë e penalltisë. Chelsea arriti të barazonte shifrat me Jackson në minutën e 67', duke i dhënë shpresë skuadrës së drejtuar nga Pochettino. Mrekullia afatshkurtër për City ndodh në minutën e 86', pasi Rodri i jep avantazhi 3-4 skuadrës së tij.

Por nuk mbaroi këtu, pasi në minutën e 95', Chelsea fiton një 11 metërsh falë Armando Brojës dhe Palmer shënon duke barazuar rezultat në 4-4. Me këtë rezultat, City mbetet ende në vendin e parë me 28 pikë, ndërsa Chelsea në vendin e 10 me 16 pikë.



